



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori III 2021

Përmbajtje

I . HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE	4
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare	4
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare	6
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar	7
4. Treguesit e shërbimit ekspres.....	8

I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për tremujorin e tretë të vitit 2021 dhe krahasimet me tremujorin e dytë të këtij viti dhe me tremujorin e tretë të vitit 2020, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika rreth AKEP”-“Shërbimet Postare”

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e tretë të vitit 2021 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (27 subjekte)¹:**
 1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S);
 2. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx);
 3. Albanian Parcel Distribution shpk;
 4. Alfa Courier Services shp.k;
 5. Armonela Bala (Person fizik);
 6. Balkan Courier & Logistics sh.p.k;
 7. COEX shpk;
 8. DHL International (Albania) sh.p.k;
 9. E-KOMPLET sh.p.k;
 10. Express Delivery Tirana sh.p.k.
 11. Fast Express Post sh.p.k.
 12. Fenix Post & Delivery Albania sh.p.k;
 13. Flash Delivery Albania;
 14. Flatra;
 15. Gerhard Veizi (Person fizik)
 16. Greenposta sh.p.k;
 17. IDEX IdealExpress sh.p.k;
 18. Intex Courier sh.p.k;
 19. Mr. Courier sh.p.k;
 20. NOEX Courier & Delivery sh.p.k;
 21. Prime Express sh.p.k;
 22. TNT Express Albania sh.p.k;

¹ Ofrues të shërbimeve postare që kanë raportuar të dhënat statistikore në AKEP deri më, 28.10.2021

- 23. Top Post sh.p.k;
- 24. Turboo Albania sh.p.k;
- 25. Ulysses Enterprises sh.p.k;
- 26. United Transport sh.p.k (Uni Trans);
- 27. Youth Albania Professional Services (YAPS).

Gjatë periudhës, nga tremujori i dytë deri në tremujorin e tretë të vitit 2021, janë ç’regjistruar tre subjekte për ofrimin e shërbimeve postare.

Posta Shqiptare me VKD Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

- 1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare
- 2. Treguesit e shërbimit universal postar;
- 3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
- 4. Treguesit e shërbimit ekspres

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021 rezultojnë 6,947,154 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të detajuara si më poshtë:

Tabela 1.1: Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara

Shërbime postare të ofruara	T1_2020	T2_2020	T3_2020	T4_2020	T1_2021	T2_2021	T3_2021	Ndryshim T3_2021/ T2_2021	Ndryshim T3_2021/ T3_2020
Posta Shqiptare sh.a									
1 Shërbim Universal Postar									
1.1 Postë brenda vendit	5,306,046	2,905,495	4,515,612	4,760,385	4,989,939	4,956,577	5,113,495	3.2%	13%
1.2 Postë ndërkombëtare	162,172	73,152	449,011	219,001	175,779	161,672	155,708	-3.7%	-65%
1.3 Totali 1.1+1.2	5,468,218	2,978,647	4,964,623	4,979,386	5,165,718	5,118,249	5,269,203	2.9%	6%
2 Shërbim jouniversal postar									
2.1 Postë brenda vendit	330,349	165,027	188,496	189,640	136,189	67,381	117,301	74.1%	-38%
2.2 Postë ndërkombëtare	620	290	159	198	388	341	707	107.3%	345%
2.3 Totali 2.1+2.2	330,969	165,317	188,655	189,838	136,577	67,722	118,008	74.3%	-37%
3 Shërbim ekspres									
3.1 Ekspres brenda vendit	138,772	126,563	120,632	100,564	144,200	168,882	183,171	8.5%	52%
3.2 Ekspres ndërkombëtar	3,465	1,988	3,986	3,435	4,779	5,018	4,515	-10.0%	13%
3.3 Totali 3.1+3.2	142,237	128,551	124,618	103,999	148,979	173,900	187,686	7.9%	51%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare									
4 Shërbim JoUniversal Postar									
4.1 Postë brenda vendit	221,482	484,711	701,719	677,751	720,541	513,925	365,123	-29.0%	-48.0%
4.2 Postë ndërkombëtare	9,650	10,609	13,202	25,668	16,830	9,200	19,026	106.8%	44.1%
4.3 Totali 4.1+4.2	231,132	495,320	714,921	703,419	737,371	523,125	384,149	-26.6%	-46.3%
5 Shërbim ekspres									
5.1 Ekspres brenda vendit	588,199	630,510	769,419	788,390	683,062	724,847	927,403	27.9%	20.5%
5.2 Ekspres ndërkombëtar	52,892	56,336	77,529	83,771	68,688	53,672	60,706	13.1%	-21.7%
5.3 Totali 5.1+5.2	641,091	686,846	846,948	872,161	751,750	778,519	988,109	26.9%	16.7%
6 Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	6,813,647	4,454,681	6,839,765	6,848,803	6,940,395	6,661,515	6,947,154	4.3%	1.6%

Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e tabelës 1.1, shikojmë një rritje të zërit postë brenda vendit, në shërbimin universal postar, në T3_2021 krahasuar me T2_2021 konkretisht me rreth 3%, nëse krahasojmë të njëjtën periudhë me atë të një viti më parë, rritja është më e lartë rreth 13%. Në lidhje me zërin postë ndërkombëtare të ofruesit të shërbimit universal, kemi një rënie si për periudhën T3_2021 krahasuar me T2_2021, ashtu edhe për T3_2021 krahasuar me T3_2020. Në lidhje me shërbimin jo-universal postar të Postës Shqiptare, shikojmë një rritje me 74.1% të zërit postë brenda vendit në T3_2021 krahasuar me T2_2021 dhe një rënie të këtij zëri krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë me rreth 38%. Zëri i postës ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare, rezulton me rritje krahasuar T3_2021 me T2_2021, si edhe konstatohet një rritje e këtij zëri krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Zëri poste ekspres ndërkombëtare i PSH, ka pësuar rënie me rreth 10% gjatë T3_2021 krahasuar me T2_2021 dhe një rritje prej rreth 13% për T3_2021 krahasuar me T3_2020.

Zëri postë brenda vendit, në shërbimin jo-universal postar për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, rezulton me rënie si për T3_2021 krahasuar me T2_2021, ashtu edhe për të njëjtën periudhë krahasuar me një vit më parë.

Në lidhje me zërin, postë ndërkombëtare për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, kemi një rritje të konsiderueshme prej 107% në T3_2021 krahasuar me T2_2021, rritje e këtij zëri është evidentuar edhe nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë një vit më parë. Zëri poste ekspres brenda vendit për ofruesit e tjerë, rezulton me rritje krahasuar T3_2021 me T2_2021, rritja evidentohet edhe nëse krahasojmë periudhën T3_2021 me T3_2020. Zëri postë ekspres ndërkombëtare, për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, ka rritje në T3_2021 krahasuar me T2_2021 dhe një rënie krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.


Tabela 1.2: Totali i objekteve postare (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare) T3_2021

	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	5,574,896	80%
<i>Of. e tjerë</i>	1,372,258	20%
<i>Totali</i>	6,947,154	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën sa më sipër, evidentohet se Posta Shqiptare (Ofrues i Shërbimit Universal) zë rreth 80% të totalit të objekteve postare të përpunuara nga ofruesit e shërbimeve postare.

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, shikojmë një rritje në objektet postare në T3_2021 krahasuar me T2_2021, si për Postën Shqiptare ashtu edhe për ofruesit e shërbimeve postare, gjithashtu kemi një rritje të objekteve postare krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.


Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T3_2021

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh. ekspres	Totali
5,269,203	502,157	1,175,795	6,947,154
75.8%	7.2%	16.9%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e raportuara rezultojn se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me rreth 75.8%, ndjekur nga shërbimi ekspres me 16.9% dhe shërbimi jo universal 7.2%.

Grafiku 1.2: Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar. Nga krahasimi i periudhës T3-2021 me periudhën T2-2021 vërehet një rritje e shërbimeve postare me 4.3%, gjithashtu rritje vërehet dhe krahasuar me të njëjtën periudhë, një vit më parë, në vlerën 1.6%.

2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T3-2021


Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	5,113,495

Postë ndërkombëtare	155,708
Totali	5,269,203

Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga të dhënat e tabelës 1.4 për tremujorin e tretë 2021, për sa i përket shërbimit Universal Postar, vihet re se Posta Shqiptare realizoi gjithsej 5,269,203 objekte, nga të cilat posta brenda vendit zë 97% të objekteve postare dhe posta ndërkombëtare zë 3% të objekteve postare. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 4,393,617 shërbime për objekte të thjeshta dhe 719,879 shërbime për objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 40,693 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 115,015 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 muajor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga grafiku i mësipërm, shikohet një rritje e shërbimit universal postar në T3_2021 krahasuar me T2_2021, me 2.9%.

3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare

Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:


Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Shqiptare

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T3_2021	Pjesë tregu T3_2020
Shërbim universal postar	5,269,203	95%	94%
Shërbim jo universal postar	118,008	2%	4%
Shërbim ekspres	187,686	3%	2%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 95%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 3% dhe nga shërbimi jo universal postar 2%.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare, ku vihet re një rritje për shërbimin universal dhe për shërbimin ekspres në T3_2021 krahasuar me T3_2020, si dhe një rënie për shërbimin jo universal postar. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm kemi një rritje të tre këtyre shërbimeve.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T3_2021	Pjesë tregu T3_2020
P.Sh	118,008	24%	21%
Of. e tjerë	384,149	76%	79%
Totali	502,157	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në T3_2021 krahasuar me T2_2021 kanë pësuar rritje për Postën Shqiptare dhe një rënie për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë T3_2021 përbëhet nga 482,424 objekte brenda vendit dhe 19,733 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.

5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2021, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2020, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare) për T3_2021

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T3_2021	Pjesë tregu T3_2020
P. Shqiptare	187,686	16%	13%
Of. e tjerë	988,109	84%	87%
Totali	1,175,795	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Shërbimi ekspres, gjatë T3_2021 ka pasur rritje të shërbimeve postare ekspres e krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2020, si edhe me tremujorin paraardhës T2_2021.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë së bashku është në vlerat 1,110,574 objekte postare ose 94%, dhe shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 65,221 objekte postare ose 6%.

Për sa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri është në vlerën 40,873 objekte dhe sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit është në vlerën 24,348 objekte.